

“TALLKU” SH.P.K.
POMPA E DERIVATEVE “ARIA PETROL 1”
Arllat, Komuna Glllogoc



RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR POMPEN E
DERIVATEVE “ARIA PETROL 1” ME INFRASTRUKTURË
PËRCJELLËSE NË ARLLAT, KOMUNA GLLOGOC

Glllogoc, Prill – 2025

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR POMPEN E
DERIVATEVE “ARIA PETROL” ME INFRASTRUKTURË PËRCJELLËSE NË
ARLLAT, KOMUNA GLLOGOC**

Parcela nr. 02657-0, Zona kadastrale Arllat, Komuna Gllogoc

	Emri		Hartueset e Raportit të VNM-së
Aplikuesi	Gresa Rrustemaj		Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari
Investitori:	“TALLKU”SH.PK. Pronar: Gresa Rrustemaj		
Adresa:	UÇK, pn		Gllogoc
Lokacioni i Pompës	Arllat, komuna e Gllogocit Rruga Magjistrale M9 Prizren – Prishtinë		
Tel:	+383 49 185 589		+383 49 588 634
Email:	tallkushpk@gmail.com		Blerinabajraktari1@gmail.com

Nënshkrimi

v.v.

Nënshkrimi

Gllogoc, Prill -2025

PËRMBAJTJA:

1.	HYRJE	1
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së	2
3.	PËR KOMPANINË.....	3
a)	Vendndodhja e Projektit.....	4
b)	Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit	6
c)	Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit	9
d)	Përshkrimi detal i procesit teknologjik	11
e)	Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit	12
4.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME	14
5.	GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT	15
5.1	Ndotësit Kryesorë.....	15
5.2	Flora dhe Fauna	16
5.3	Transporti rrugor dhe Hekurudhor.....	16
5.4	Mbeturinat e ngurta.....	17
5.5	Hidrografia	17
5.6	Ndryshimet natyrore	19
6.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	20
6.1	Ndikimet në ajër	20
6.2	Ndikimet në tokë	20
6.3	Ndikimet në ujë	21
6.4	Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë	22
6.5	Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	22
6.6	Ndikimet nga zhurma	23
6.7	Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore	23
6.8	Trashëgimia Kulturore.....	23
7.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS.....	24
8.	PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE	25
9.	PËRSHKRIMI I MASAVE.....	27
9.1	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	27

9.2	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	27
9.3.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë	28
9.3	Masat për mbrojtje nga zhurma	30
9.4	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë	31
9.5	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	31
9.6	Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore	31
9.7.	Menaxhimi i mbeturinave.....	31
9.8.	Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve	33
10.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE	35
11.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI	35
12.	PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME	36
13.	ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT:	37
14.	LITERATURA E PERDORUR.....	38

Lista e Figurave:

Figura 1.	Projekti 3D i pompës së derivateve nga kompania "Tallku" SH.P.K.....	3
Figura 3.	Parcela ku ka filluar ndërtimi i pompës së derivateve.....	4
Figura 4.	Distanca nga shtëpitë e banimit.....	5
Figura 5.	Shtirja hapësinore e lokacionit të projektit nga komuna e Glllogocit (Drenasit)	5
Figura 6.	Rezervuaret e planifikuar për vendosjen tek pompa e derivateve "ARIA PETROL"	8
Figura 7.	Situacioni i Pompës së Derivateve "ARIA PETROL" me investitor "Tallku" SH.P.K., Arllat, komuna e Glllogocit.....	8
Figura 8.	Parcela me nr. 02657-0 ku ka filluar ndërtimi i pompës së derivateve nga kompania "Tallku"SH.P.K. .	9
Figura 9.	Dukja 3D e pompës së derivateve "ARIA PETROL"	10
Figura 10	Skema e procesit teknologjik të mbushjes së rezervuarve të naftës, benzines apo gasit	12
Figura 11.	Hidrografia e Komunës së Glllogocit	18
Figura 12.	Zona e mbrojtur me e afërt është ajo e zonës me interes të veçantë Kleçkë dhe Divjak në distancë 1.26 km.....	23
Figura 13.	Grumbullimi i ujërave atmosferike dhe separatori për ndarjen e vajrave nga uji.....	29
Figura 14.	Vaske septike për para trajtim.....	29

Lista e Tabelave:

Tabela 1	Tabela e mbeturinave jo të rrezikshme sipas katalogut shtetëror të mbeturinave.....	32
----------	---	----

1. HYRJE

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) është një dokument i domosdoshëm dhe i rëndësishëm për marrjen e Pëlqimit Mjedisor nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), si dhe për pajisjen me Leje Mjedisore, e cila është kusht për operimin e pompës së derivateve. Ky raport synon të identifikojë dhe vlerësojë të gjitha ndikimet e mundshme që pompa e derivateve mund të ketë mbi mjedisin jetësor dhe mjedisin e gjerë përreth tij. Hartimi i këtij raporti bëhet me qëllim që të ofrojë një vlerësim transparent të ndikimeve mjedisore të pompës së derivateve dhe infrastrukturës përcjellëse, duke marrë në konsideratë të gjitha aktivitetet e planifikuara, përfshirë shërbimin, transportin, deponimin dhe trajtimin e lëndëve djegëse (derivateve). Ky proces është thelbësor për të garantuar mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit. Raporti i VNM-së për pompën e derivateve **“ARIA PETROL 1”** me infrastrukturë përcjellëse, e cila ndodhet në Arllat, Komuna e Glllogocit, është hartuar duke u bazuar në projektin e ndërtimit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit përreth si dhe dokumentacionin teknik përkatës. Detyra kryesore e këtij raporti është të identifikojë burimet e mundshme të ndotjes, të vlerësojë ndikimin e tyre në mjedis dhe të propozojë masa për parandalimin ose minimizimin e ndikimeve negative brenda kufijve të lejuar nga legjislacioni në fuqi. Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet e dhëna në këtë raport duhet të merren në konsideratë gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të pompës së derivateve. Megjithatë kompania ka filluar ndërtimin e saj duke qenë e pajisur me Leje Mjedisore Komunale, pasi ka rritur kapacitetin e rezervuarit, është e domosdoshme që ajo të pajiset me Pëlqim Mjedisor nga MMPHI, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore.

2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e pompës së derivateve “**ARIA PETROL**” me infrastrukturë përcjellës – Arllat, Komuna e Glllogocit dhe sipas projektit (vendndodhja, madhësia e shtrirjes, ndikimet e mundshme në mjedis etj.), ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis** i cili është baza kryesore ligjore te cilit ju kemi referuar.

Shtojca 2 e këtij ligji, paragrafi 6:

Baza ligjore për hartimin e Vlerësimit të ndikimit në mjedis për Pompën e Derivateve “**ARIA PETROL**” nga Investitori “Tallku” SH.P.K., është:

Legjislacioni:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji nr. 08/1-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110,
- Ligji Nr. 08/261 për mbrojtjen nga Zjarri

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikon për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

3. PËR KOMPANINË

Korporata Tallku është një ndërmarrje e njohur në Kosovë, e themeluar në vitin 2010. Ajo specializohet në industrinë e ndërtimit, me fokus në minierat dhe guroret e mineraleve jo metalike. Gjatë viteve, Korporata Tallku është bërë lider në fushën e ndërtimit, duke kontribuar ndjeshëm në rritjen ekonomike të Kosovës përmes projekteve të ndryshme ndërtimore. Kompania “Tallku” SH.P.K. duke e parë rritjen e kërkesave të derivateve ka vendosur të shtoj aktivitetin e furnizimit me derivate ne korporatën e saj, te cilën e ka quajtur ARIA PETROL 1 ku do te bëj hapjen e pompë së derivateve në afërsi të rrugë magjistale M9 që e lidhë Prizrenin me Prishtinën. Në Pompën e Derivateve që është duke u ndërtuar kemi një gërshetim funksionesh, si: afarizëm dhe tregti, rekreacion dhe parkim, deponimi dhe funksione teknike. Të gjitha këto funksione janë komplementare mes veti dhe e rrisin kualitetin e shfrytëzimit në këtë objekt. Pompa e Derivateve do të ofrojë gjithashtu edhe restorantin për pushim si dhe dyqanin me artikuj si ushqim, pije dhe mallra tjerë për konsum duke i bërë ato ndalesa të përshtatshme për udhëtarët për te marrë gjera te nevojshme. Pompa e Derivateve do të ofroj WC dhe zona të parkingjeve ku mund të pushojnë udhëtarët e lodhur gjatë udhëtimeve të tyre. Për pronarët e biznesit, Pompa e Derivateve mund të jenë ndërmarrje fitimprurëse për shkak të kërkesës së vazhdueshme për derivate dhe potencialit për të ardhura shtesë nga shitja me pakicë dhe ofertat e shërbimeve. Duke e parë se Pompa e Derivateve janë pjesë thelbësore e infrastrukturës së transportit, duke siguruar që automjetet të kenë akses në karburantin e nevojshëm për t'i mbajtur ato në punë. Ato luajnë një rol vendimtar në mbështetjen e lëvizshmërisë dhe komoditetit të shoferëve dhe kontribuojnë në ekonominë lokale si përmes punësimit ashtu edhe shitjes së mallrave dhe shërbimeve.



Figura 1. Projekti 3D i pompës së derivateve nga kompania "Tallku" SH.P.K.

Kompania është pajisur me Leje Mjedisore Komunale nga Komuna e Gllogoc-it por për arsye të rritjes së kapacitetit të depozitës së rezervuarve është urdhëruar që të aplikoj për Pëlqim Mjedisor në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë.

Duke u bazuar në rritjen e kërkesave dhe shfrytëzimin maksimal të derivateve kompania është duke e bërë ndërtimin e pompës së derivateve **“ARIA PETROL 1”** me lokacion në zonën kadastrale Arllat, komuna e Gllogocit.

Ky raport është hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Po ashtu qëllimi kryesor i këtij raporti të VNM-së është identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis me qëllim të marrjes së masave të nevojshme për ti minimizuar ndikimet negative në Mjedis. Pompa e derivateve me të gjitha objektet është duke u ndërtuar në Parcelat me nr.02657-0, Zona kadastrale Arllat, komuna e Gllogoc, ku prona është private dhe është ne emër te kompanisë.

a) Vendndodhja e Projektit

Lokacioni i Projektit të Pompës së Derivateve me infrastrukturë përcjellëse ndodhet në ngastrën kadastrale 02657-0, në zonën kadastrale (Zk.) Arllat, të Komunës së Gllogocit. Ndërtimi i pompës së derivateve është në afërsi të rrugës magjistrallë M9, që lidhë Prishtinën me Prizrenin dhe Pejën.




Figura 2. Parcela ku ka filluar ndërtimi i pompës së derivateve




Figura 3. Distanca nga shtëpitë e banimit

Lokacioni i Projektit ndodhet në anën e djathtë të rrugës magjistrale M9, që lidh Prishtinën me Prizrenin dhe Pejën. Lokacioni ku ka filluar ndërtimi i pompës së derivateve, së bashku me të gjithë infrastrukturën përcjellëse, është në një largësi prej 13.6 km nga Komuna e Glllogocit.




Figura 4. Shtrirja hapësinore e lokacionit të projektit nga komuna e Glllogocit (Drenasit)

Gjithashtu, shtëpitë e banimit ndodhen në një distancë mbi 549 metra nga parcela e planifikuar për ndërtim. Po ashtu, nuk ka objekte biznesore në afërsi të parcelës që ka filluar ndërtimi i pompës së derivateve.

b) Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit

Ngastra ku ka filluar ndërtimi i Pompës së Derivateve “**ARIA PETROL 1**” kufizohet: Në anën veriore-perëndimore kufizohet me rrugën kryesore (M9), ku qasja bëhet direkt nga rruga; në anët tjera kufizohet me parcelat fqinje. Objekti është me etazhitet P+0 dhe ka strehën e cila mbron nga reshjet atmosferike shërbimin me derivate që është me etazhitet P. Pompa funksionon si pompë njëdrejtimëshe ka një hyrje dhe një dalje qendrore, ku ka gjithsej 10 furnizues të cilët janë të pozicionuar në pjesën jug-perëndimore të parcelës. Kurse nga pjesa lindore, është hyrja e veçantë për në terasës. I tërë oborri është trajtuar me infrastrukturë, kanalizim atmosferik, kanalizim fekale, rrjetin e ujësjellësit, sistemin e ujitjes si dhe sistemin e ndriçimit të oborrit.

Përdhesa

Përdhesa është konceptuar me hyrje qendrore të përbashkët për në hapësirën e marketit dhe në hapësirën e restaurantit, një hyrje direkte në restaurant, hyrje për në terasë e cila lidhet me hapësirën e restaurantit, një hyrje ekonomike dhe një hyrje për shërbime teknike. Në përdhesë janë vendosur katër grupacionet kryesore funksionale. Në anën veri-lindore janë vendosur funksionet përcjellëse duke filluar nga hyrja ekonomike, kthina teknike, gardërobat dhe sanitaret për punëtorë, depot dhe frigodhomat për deponimin e ushqimeve, si dhe kuzhina kryesore e restaurantit. Kthina teknike është e destinuar për vendosjen e kaldajës dhe pajisjeve të ngrohjes dhe ftohjes. Në pjesën jug-perëndimore është e vendosur hyrja kryesore. Nga hyrja kryesore kalon në market në anën e veriore ndërsa në restaurant në anën jug-lindore i cili lidhet me terasën e objektit.

Konstruksioni

Konstruksioni i objektit është sistem mix: sistem skeletor dhe konstruksion metalik. Pjesa afariste është menduar të punohet nga betoni i armuar ndërsa mbulesa tek hapësira e derivateve është menduar të punohet nga konstruksioni metalik. Moduli i konstruksionit është i zgjedhur në bazë të hapësirave funksionale dhe zgjidhjes arkitektonike. Kulmi mbi përdhese është projektuar si kulm i rrafshët me shtresa të parapara. Streha mbi hapësirën ku janë vendosur pompat për shërbimin e derivateve është e projektuar si mbulesë me konstruksion metalik e mbështetur në katër pika mbështetje konstruktive me nga dy shtylla qift për secilën pikë

mbështetje. Themelet e strehës janë themele të veçuara dhe pllaka mbi themele është pllakë beton arme e finalizuar me ferobeton.

Muret e Jashtme

Muret e jashtme janë me trashësi 25 cm me blloka të siporeksit të trajtuara nga ana e mbrendshme me llaç dhe gletim kurse nga ana e jashtme me veshje me fasadë të ventiluar me termoizolim lesh guri $t = 8$ cm. Ana ballore është e punuar me fasadë kontinuale nga alumini me xham tero E-low me efqiience termike shumë të mirë me koeficient termik $1.1 \text{ W/m}^2 \text{ K}$. këto mure në pjesën hyrëse te objektit në përdhësë shërbejnë që të kemi një lidhje më të mirë vizuale nga jashtë me pjesën e brendshme të objektit.

Muret e Brendshme

Të gjitha muret e brendshme janë nga blloqet e siporeksit të cilat do të suvatohen me llaç dhe do gletohen deri në finale. Muret të cilat i ndajnë nyjet sanitare, depotë dhe kuzhinën janë mure nga blloqet e siporeksit te suvatuara me llaç me baze qimentoje dhe të mveshura me pllaka të qeramikës.

Dyshemetë

Në të gjitha hapësirat, sanitaret, gardërobat, kuzhina është menduar të vendosen pllakat e keramikës teknike kurse në pjesët tjera ku janë marketi, restoranti dhe administrate janë me pllaka porcelan.

Ndriçimi

Ndriçimi në hapësirat funksionale kryesisht është ndriçim natyral por ka edhe ndriçim artificial të dimensionuar në mënyrë adekuate për funksion të objektit.

Zgjidhja arkitektonike e objektit

Zgjidhja arkitektonike e objektit ose forma e objektit është kryesisht si rezultat i funksionit të brendshëm dhe idesë së arkitekturës të cilën e kemi menduar. Është një arkitekturë e kombinuar nga arkitektura organike për nga forma, dhe në momente për nga përdorimi i materialeve, si dhe në anën tjetër shihen disa lëvizje të arkitekturës moderne. E gjitha e projektuar duke menduar qëndrueshmërinë urbane.

Rezervuarët dhe kapaciteti i tyre

Tek Pompa e derivateve janë parapare të vendosen 7 Rezervuar me kapacitet $R_1=12000 \text{ L}$, $R_2=12000 \text{ L}$, $R_3=20000 \text{ L}$, $R_4=5000 \text{ L}$, $R_5=26000 \text{ L}$ dhe $R_6=26000 \text{ L}$ naftë dhe benzinë, si dhe rezervuari i gazit të lëngëzuar $R=5000 \text{ L}$.




Figura 5. Rezervuaret e planifikuar për vendosjen tek pompa e derivateve "ARIA PETROL 1"



Figura 6. Situacioni i Pompës së Derivateve "ARIA PETROL 1" me investor "Tallku" SH.P.K., Arllat, komuna e Gllgocit



Figura 7. Parcela me nr. 02657-0 ku ka filluar ndërtimi i pompës së derivateve nga kompania "Tallku"SH.P.K.

c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Faza operative e projektit të pompës së derivateve "ARIA PETROL 1" përfshin funksionimin e pompës së derivateve dhe menaxhimin e veprimtarive të lidhura me ofrimin e shërbimeve të derivateve dhe mbështetjes infrastrukturore. Gjatë kësaj faze, do të realizohen disa veçori të rëndësishme që ndihmojnë në operimin e suksesshëm të objektit dhe sigurinë mjedisore:

- **Furnizimi dhe Shitja e Derivateve:** Pompa do të operojë me furnizim të vazhdueshëm të derivateve, duke përfshirë naftë, benzinë dhe gaz të lëngëzuar, me të cilin do të furnizohen nga kompani të licencuara jashtë shtetit të Kosovës, dhe do të ruhen në rezervuarë të sigurt nën tokë. Pompat do të jenë të automatizuara me sistem digjital për matje, faturim dhe raportim. Gjithsej do të ketë 10 stenda të mbushjes.
- **Lënda e pare :** Sa i përket komponentëve kryesore, për pompën e derivateve, janë:
 - Derivatet e naftës dhe benzinës dhe gazit,

Ndërsa komponentët ndihmës janë:

- Energjia elektrike,
- Uji.

- **Shërbime Shtesë:** Përveç derivateve, pompa do të ofrojë shërbime si market, restaurant dhe hotel, të cilat synojnë të rrisin komoditetin e udhëtarëve.
 - **Funksionimi i marketit:** Marketi do të ofrojë produkte të konsumit të përditshëm, pije, ushqim të shpejtë, aksesore për automjete dhe pajisje teknike. Do të punojë në orar të plotë (24/7), me sistem të kontrollit të inventarit dhe arkës digjitale. Do të ketë mbikëqyrje me kamera dhe sistem alarmi për siguri.
 - **Funksionimi i restaurantit:** Restoranti do të ofrojë shërbime ushqimore për klientët e rastit dhe ata të akomoduar në hotel. Kuzhina do të jetë e pajisur sipas standardeve të sigurisë ushqimore, me staf të trajnuar dhe higjienë të rreptë. Menyja do të jetë e larmishme dhe do të mundësojë shërbime 24-orëshe ose sipas orarit të përcaktuar.
- **Sistemet mbështetëse dhe siguria:**
 - Objekti do të jetë i pajisur me sisteme kundër zjarrit, mbikëqyrje me kamera dhe alarm për raste emergjente.
 - Do të ketë sistem ndriçimi dhe sinjalistikë të brendshme dhe të jashtme për orientimin e klientëve.
 - Zbatimi i masave për mbrojtjen e mjedisit (trajtim i ujërave të ndotura, ndarja e mbeturinave, kursimi i energjisë).
- **Stafi dhe menaxhimi:** Do të angazhohet staf i kualifikuar për secilën njësi (pompë, restaurant, market, hotel), i trajnuar në shërbim ndaj klientit dhe në procedura sigurie. Menaxhimi i të gjitha njësive do të bëhet përmes një sistemi të integruar për administrim dhe kontroll financiar-operativ.



Figura 8. Dukja 3D e pompës së derivateve "ARIA PETROL 1"

d) Përshkrimi detal i procesit teknologjik

Një pompë e derivateve zakonisht i referohet një lokacioni ku automjetet mund të furnizohen me derivate të lëngëta si naftë, benzinë dhe gaz. Procesi teknologjik i punës së pompës së derivateve përfshin disa komponentë dhe procese kryesore.

Këtu është një përmbledhje e përgjithshme:

-  **Depozitat e ruajtjes së derivatit** – Pompat e derivateve zakonisht kanë rezervuarë nëntokësorë për ruajtjen e derivateve të lëngshëm. Këto tanke janë krijuar për të përmbushur rregullat e sigurisë dhe mjedisit.
-  **Dorëzimi i derivatit** - Derivatet shpërndahet në rezervuarët e magazinimit me kamionë cisternë. Këta kamionë transportojnë sasi të mëdha derivatit nga rafineritë ose qendrat e shpërndarjes në pompën e derivateve.
-  **Dispenzuesit e derivatit** - Shpërndarësit e derivateve janë makinat që pompojnë derivatin në automjete. Ato janë të pajisura me hundë, çorape dhe matës për të kontrolluar me saktësi rrjedhën e derivatit.
-  **Sistemet e pagesave:** pompat moderne të derivateve janë të pajisura me sisteme pagese që lejojnë klientët të paguajnë për derivate. Kjo mund të përfshijë lexuesit e kartave të kreditit/debitit, opsionet e pagesave në celular dhe ndonjëherë transaksione në para.
-  **Sistemet e monitorimit dhe kontrollit** - Për të garantuar siguri dhe funksionim efikas, pompa e derivateve shpesh kanë sisteme monitorimi dhe kontrolli. Këto sisteme mund të përfshijnë sensorë për të zbuluar rrjedhjet, për të matur nivelet e derivateve dhe për të monitoruar gjendjen e përgjithshme të infrastrukturës së derivatit.
-  **Masat mbrojtëse mjedisore** - Mbrojtja e mjedisit është një aspekt thelbësor i pompave të derivateve. Ata mund të kenë mekanizma për të parandaluar derdhjet, sisteme të zbulimit të rrjedhjeve dhe protokolle për trajtimin e emergjencave të lidhura me derivatin.
-  **Pajtuëshmëria rregullatorë** – Pompa e derivateve duhet të jenë në përputhje me rregullore dhe standarde të ndryshme që lidhen me sigurinë, ndikimin mjedisor dhe kontrollin e cilësisë. Inspektimet e rregullta dhe respektimi i udhëzimeve janë thelbësore.
-  **Mirëmbajtja dhe mirëmbajtja** - Mirëmbajtja e rregullt është thelbësore për funksionimin e qetë të pompës së derivateve. Kjo përfshin kontrollimin e pajisjeve, sigurimin e saktësisë së shpërndarësit dhe trajtimin e menjëhershëm të çdo problemi.

🚦 **Automatizimi dhe Integrimi** - Disa pompa të derivateve janë të pajisura me sisteme automatizimi dhe integrimi. Kjo mund të përfshijë analizat e të dhënave për të optimizuar menaxhimin e inventarit, furnizimin e automatizuar të derivatit për shërbimet e flotës ose integrimin me sisteme të tjera biznesi.

🚦 **Ndërveprimi me klientët** – pompat e derivateve shpesh kanë ndërfaqe me klientët për përdoruesit për të zgjedhur llojet e derivatit, për të futur informacionin e pagesës dhe për të marrë faturat. Ndërfaqet miqësore për përdoruesit përmirësojnë përvojën e përgjithshme të klientit.

Është e rëndësishme të theksohet se funksionet specifike teknologjike mund të ndryshojnë në bazë të nivelit të automatizimit, madhësisë së pompës së derivateve dhe teknologjisë së disponueshme. Për më tepër, përparimet në teknologji mund të çojnë në ndryshime dhe përmirësime në procesin e furnizimit me derivat me kalimin e kohës.




Figura 9 Skema e procesit teknologjik të mbushjes së rezervuarve të naftës, benzines apo gasit

e) Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit

Me poshtë do të përshkruajmë të gjitha emetimet e pritura gjatë fazës së ndërtimit dhe gjatë operimit:

Uji: Gjatë fazës së ndërtimit, mund të ndodhin disa ndikime të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në burimet ujore për shkak të aktiviteteve si gërmimi, niveli i ndotjes, dhe përdorimi i materialeve ndërtimore. Faza e operimit përfshin proceset e shpërndarjes së derivateve, ruajtjes dhe menaxhimit të derivateve nëse nuk menaxhohen si duhet mund të çojë në ndikime të mëtejshme në ujë.

Ajri: Gjatë ndërtimit, ndotja e ajrit shkaktohet nga pluhuri, transporti i materialeve dhe makineritë që lëshojnë NO₂, CO, SO₂ dhe PM. Gjatë funksionimit, ndotja vjen nga

qarkullimi i automjeteve dhe avullimi i derivateve, duke çliruar CO, NOx, HxCy, SO₂ dhe Pb. Ndikimi varet nga kushtet klimatike dhe dendësia e trafikut.

Dheu – Ndërtimi dhe operimi i pompës së derivateve ndikon në cilësinë dhe integritetin e tokës, kryesisht përmes ndryshimeve strukturore dhe ndotjes nga hidrokarburet. Gjatë ndërtimit, proceset e gërmimit dhe kompaktimit reduktojnë porozitetin e tokës, rrisin rrezikun e erozionit dhe ndotjes nga derdhjet aksidentale të derivateve dhe mbetjeve ndërtimore. Gjatë operimit, ndotja kryesore vjen nga rrjedhjet e mundshme të rezervuarëve të derivateve dhe mbetjeve të ngurta nga infrastruktura përcjellëse, duke rrezikuar burimet ujore dhe ekosistemet përreth.

Zhurma – gjatë ndërtimit e po ashtu edhe gjatë operimit mund të ketë zhurmë gjatë lëvizjes së makinerive e cila është e pranueshme sipas normave, po ashtu edhe gjatë operimit është minimale.

Drita, nxehtësia dhe rrezatimi – Janë tri dukuri që të trijat se bashku të ndihmojnë në realizimin e punës ku lokacioni ku është duke u ndërtuar pompa e derivateve ka drite, rrezatim diellor dhe nxehtësi të mire.

Flora dhe Fauna – ndikimi në florë dhe faunë pritet të jetë i papërfillshëm. Lokacioni i planifikuar për ndërtimin e pikës së derivateve është aktualisht i përdorur si parking për makineri të rënda, duke mos pasur zhdukje të vegjetacionit përveç sipërfaqeve nën objekte dhe plato. Për faunën, ndikimi negativ është i papritur, pasi prania e mëparshme e makinerive të rënda ka kufizuar zhvillimin e saj në këtë zonë.

Ndikimet sociale dhe ekonomike – Mund të thuhet se ky aktivitet nuk do të paraqes ndonjë ndikim negativ në komunitetin lokal pasi është largë nga vendbanimi. Përkundrazi, priten efekte pozitive, ku me zhvillimin ekonomik të zonës dhe ndihmon në mbështetje përmes punësimit të komunitetit lokal në këtë pompë derivate, njëkohësisht popullata mund të relaksohet dhe të ushqehet në restorantin e kompanisë e cila i plotëson të gjitha nevojat e qytetarëve të asaj zone.

4. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME

Përzgjedhja e lokacionit për ndërtimin e pompës së derivateve është bërë duke marrë në konsideratë disa faktorë kyç, të cilët ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe minimizimin e ndikimeve mjedisore. Këta faktorë përfshijnë aspektet mjedisore, sociale dhe ekonomike, të cilat janë analizuar në mënyrë të hollësishme si më poshtë:

Afërsia me Infrastrukturën Rrugore

- Lokacioni është i pozicionuar pranë rrugës magjistrale M9 që lidh Prizrenin me Prishtinën me qarkullim të lartë të automjeteve.
- Kjo qasje e mirë mundëson furnizim efikas të pompës me derivate, si dhe shërbim të lehtë për klientët.
- Reduktohet nevoja për ndërtimin e rrugëve të reja, duke shmangur ndërhyrje të panevojshme në mjedis.
- Lehtësohet qarkullimi i automjeteve të transportit të derivateve pa krijuar bllokime apo rreziqe për trafikun ekzistues.

Zonifikimi dhe Përputhshmëria me Planet Hapësinore

- Sipas Planit Zhvillimor Komunal të Glogocit, lokacioni i zgjedhur është në zonë ndërtimore
- Përdorimi i tokës në këtë zonë është në përputhje me ligjet dhe rregulloret për planifikimin hapësinor, duke siguruar zhvillim të qëndrueshëm.

Ndikimi Minimal në Zonat e Banuara dhe Ambientin

- Lokacioni nuk ndodhet në afërsi të zonave të ndjeshme si shkolla, spitale ose zona të dendura urbane.
- Distanca e sigurt nga zonat e banuara ul ekspozimin e popullsisë ndaj emisioneve të gazrave dhe ndotjes akustike.
- Zona përreth nuk është e mbrojtur si habitat natyror i ndjeshëm, çka e bën më të përshtatshme për këtë lloj zhvillimi.
- Ndikimi vizual është i ulët, pasi pompa përshtatet me infrastrukturën ekzistuese pa prishur ekosistemin përreth.

5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Ndotja e mjedisit është rezultat i shumë faktorëve si: industria, ndërtimet ilegale, infrastruktura joadekuate, shtimi i numrit të automjeteve, importimi i automjeteve të vjetruara në Kosovë, importi i vajrave dhe derivateve të kualitetit të dobët (me sasi të lartë të sulfurit), deponimi joadekuat i tyre, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, prerja e pakontrolluar e pyjeve, akumulimi i plehrave urbane si pasojë e menaxhimit të dobët, mungesa së riciklimit, etj. Duke konsideruar prezencën e shumicës së faktorëve të lartpërmendur, gjendja e mjedisit në komunën e Gllogocit nuk mund të konsiderohet në nivel të kënaqshëm. Industria e prodhimit të metaleve (NeWCo Feronikeli) është një nga industritë me ndikim më të madh mjedisor në Kosovë, edhe pse vërehet ulje e emisioneve që vijnë si rezultat i aktiviteteve të tyre. Sektori i transportit dhe infrastrukturës së tij është një ndër sektorët që ka ndikim mjaft negativ në gjendjen e mjedisit ngase ndikon në fragmentimin dhe degradimin e habitateve (biodiverzitetit), ndryshimin e peizazhit, shfrytëzimin e tokës dhe trashëgiminë kulturore. Kjo gjendje e kërcënon mjedisin duke shkaktuar ndotjen e ujit, ujërave nëntokësore, ajrit dhe dheut. Si pasojë kemi dëmtimin e resurseve natyrore dhe humbje të tokës bujqësore. Shfrytëzimi joracional dhe pa kritere të ujit, tokës si dhe pyjeve është një tjetër çështje që duhet të konsiderohet si çështje serioze në të ardhmen. Është përgjegjësi komunale që të mbrojë dhe ruaj mjedisin natyror dhe jetësor (urban dhe rural) nga dëmtimi, degradimi apo ndotja si pasojë e veprimtarisë njerëzore ose të ndikimit natyror.

5.1 Ndotësit Kryesorë

Përdorimi i drurit për ngrohje është njëri nga kontribuuesit më të mëdhenj të ndotjes së ajrit dhe burimi kryesor i pluhurit grimcor. Ndotësit më të mëdhenj nga zjarri i drurit janë pluhuri grimcor, karboni i zi, hidrokarbonet poli-aromatike dhe dioksinat. Përveç tjerash, zjarri nga druri shkakton edhe oksidet e azotit dhe monoksidin e karbonit. Në Kosovë zjarri nga druri që përdoret kryesisht në sektorin e banimit përbën rreth 20% të konsumit të përgjithshëm të energjisë. Bazuar në përllogaritjet e GAINS, sektori i banimit përbën gati gjysmën e emetime të pluhurit grimcor PM2.5 dhe pothuajse 80% të emetimeve të karbonit të zi për vitin 2015.

Komuna e Gllogocit nuk posedon sistem të ngrohjes qendrore, prandaj shumica dërmuese e banorëve shfrytëzon drurin si burim të vetëm për ngrohje duke shkaktuar ndotje të konsiderueshme të ajrit, në veçanti gjatë periudhës së dimrit, po ashtu ndotësi me i madh në këtë komunë është: Industria e prodhimit të metaleve (NeWCo Feronikeli).

5.2 Flora dhe Fauna

Komuna e Gllogocit ka një pozite të mire gjeografike me një hidrografi të pasur dhe shtrije mjaft të madhe gjeografike, e cila përfshinë zonat mesatarisht të larta dhe zonal e ulëta të terrenit. Në këtë komunë, sa i përket biodiversitetit lidhur me llojet e bimëve këtu kemi mjaft larmishmerie të bimëve nga ato barishtore njëvjeçare deri te ato shumëvjeçare dhe drunore apo brezat të pyjeve. Nga brezi i shpërdhit me qarr shkon deri te brezi i ahut dhe shkozës. Brezi i pyjeve të shpërdhit me qarr bungut janë brezi me i dëmtuar nga faktori njeri. Ndërkaq në zonal e ulëta kemi vegjetacionin e livadheve me shoqërime mjaft të mëdha dhe të begatshme me lloje. Po ashtu në këto zona e gjejmë edhe vegjetacionin përgjatë rrugëve dhe vendbanimeve por, edhe barërat e këqija të cilat gjenden në tokat djerrina, në kufi të parcelave dhënë afërsi të gjerdeheve.

5.3 Transporti rrugor dhe Hekurudhor

Komuna e Gllogocit është e pozicionuar në qendër të Republikës së Kosovës, ngjashëm qyteti i Gllogocit është i pozicionuar në qendër të shtrirjes hapësinore të komunës. Kjo përparësi i mundëson që të gjitha vendbanimeve në komunë të kenë lidhje të afërta rrugore me qytet, si dhe i jep përparësi komunës së Gllogocit përmes lidhjeve të mira me të gjitha komunat në Kosovë. Sipas regjistrimit të rrugëve në nivel komunal, gjatësia e përgjithshme e rrjetit rrugor është 570.20km, prej të cilave 512.5km janë rrugë lokale, 35.4km janë rrugë regjionale, 19.53km janë rrugë nacionale, si dhe 2.78km janë autoudhë. (Shënim: Gjatësia tek rrugët me 4 korsi është llogaritur vetëm me një anë të rrugës). Në mungesë të kategorizimit të rrugëve (sipas normave të planifikimit apo Ligjit për Rrugë), të gjitha rrugët në menaxhim të Komunës janë të përcaktuara si rrugë lokale. Në mungesë të informatave, në analiza nuk janë të përfshira rrugët e kodrave apo rrugët e tokave bujqësore. Infrastruktura rrugore në komunë është kryesisht e modelit me dy korsi, përveç rrugës nacionale Prishtinë-Pejë në gjatësi prej 19.53km, si dhe segmentit të shkurtër të autoudhës Rruga e Kombit me gjatësi 2.78km të cilat janë me 4 korsi. Rruga nacionale Prishtinë-Pejë, segmenti i autoudhës, rrugët tjera nacionale dhe regjionale shërbejnë si nyje kyçe për transport rrugor dhe gjendja e tyre konsiderohet të jetë kryesisht e mirë. Në total rrjeti rrugor lokal është në gjatësi prej 570.20km, prej tyre rrugë me zhavorr janë 258.21km (56.49%) dhe të asfaltuara janë 335.22km (43.21%) (shih shtojcën). Rrjeti rrugor lokal i komunës së Gllogocit lidhet me rrjetin e rrugëve nacionale përmes rrugëve Prishtinë-Pejë dhe asaj regjionale Mitrovicë-Lipjan.

Komuna e Gllogocit e ka rrjetin hekurudhor me pesë terminale hekurudhore në Dobroshec, Gllogoc, Damanek, Baicë dhe Tërdec. Në shërbim të udhëtarëve janë 3 operime ditore në linjën

Fushë Kosovë – Gllogoc – Pejë. Infrastruktura hekurudhore është nën menaxhim të kompanisë publike 'TRAINKOS'. Përveç një laurete (-kufizuese apo barriere) në qytet, asnjë vendbanim nuk ka laureta mbrojtëse në kryqëzimin e rrugëve me hekurudhë dhe kjo paraqet rrezik të madh për banorët.

4.3 Mbeturinat e ngurta

Komuna e Gllogocit është ndër më të avancuarat në këtë fushë. Ka hartuar Plan të menaxhimit të mbeturinave (2015-2020), Orar të grumbullimit të mbeturinave, si dhe Rregullore për menaxhimin e mbeturinave (Nr. 501-1768 të datës 27 dhjetor 2012). Këto plane zbatohen mjaft mirë, që tregon fakti se në komunën e Gllogocit të gjitha vendbanimet (100%) janë të mbuluara me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave. Kjo mbulueshmëri në nivel të Kosovës deri në fund të vitit 2016 qëndron në 57.8%. Në anën tjetër, sipas Raportit të Performansës së Komunës së Gllogocit, 45.5% e ekonomive kanë qasje në sistemin për grumbullimin e mbeturinave. Në qytet mbledhja e mbeturinave bëhet për çdo ditë, në fshatra 1 herë në javë, në ditët e caktuara. Ofrimi i mbledhjes së mbeturinave është shumë i qëndrueshëm, për çka tregon realizimi 99.7% i orarit për mbledhjen e mbeturinave në vit. Grumbullimi bëhet përmes 102 kontejnerëve me vëllim prej 1,1m³, 6 kontejnerë të madhësisë 7 m³, e në fshatra grumbullimi bëhet përmes 6095 shportave prej 120 l dhe 72 shportave të madhësisë prej 240 litrave (2015). Grumbullimi i mbeturinave vazhdon përmes kamionit dhe zbrazja e tij bëhet çdo ditë në deponi të transferit, të cilat më pastaj dërgohen në deponinë rajonale në Mirash. Në ditë grumbullohen dhe zbrazen 30 tonë mbeturina. Sasia e deponimit të mbeturinave për kokë banori në vit është 105.7kg. Deponia e transferit ndodhet pranë minierës së Feronikelit në Gllogoc. Arkëtimi është 87%, në nivel të Kosovës vlerësohet se është rreth 60%. Se fundmi, ka filluar edhe procesi i ndarjes së mbeturinave në burim, ku janë caktuar 16 pika të grumbullimit të mbeturinave në qytet me kontejnerë 1.1 m³ për banime kolektive dhe institucionet publike me shporta 240 litërshe, në të cilat janë të vendosur 2 lloje të kontejnerëve, për të përziera dhe mbeturina të riciklimit. Përkundër mbulueshmërisë shumë të mirë me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, në territorin e komunës ka deponi të ndryshme ilegale që janë krijuar me kohë.

5.4 Hidrografia

Hidrografia- Lumi kryesor që kalon nëpër komunën e Gllogocit është Drenica, e cila është degë e majtë e lumit Sitnica dhe i takon pelgut të Ibrit. Ajo buron në Bretenc te mali Cërralevë.



Figura 10. Hidrografia e Komunës së Glogocit

¹ Pzhk Komunal Glogoc

Drenica që nga Gllogoci e deri në Bardh i Madh, hyn në një pjesë të ngushtë, duke marrë pamjen e një gryke. Në këtë pjesë të lumit pjerrtësia është më e madhe, gjerësinë më të madhe (10 m) dhe me pjerrtësi të butë derdhet në Sitnicë. Prurja mesatare e lumit Drenica në Sitnicë është 2,0 m³/s. Drenica ka dhe degëzimet e veta siç është Verbofc. Në territorin e komunës së Gllogocit ndodhet edhe Liqeni i Vasilevës. Gjithashtu, në territor të komunës gjendet edhe burimi i ujit mineral në Poklek me temperaturë 13.0° C , pH 6.3., rrjedhje 1.00 l/s dhe mineralizim 3.52 si dhe ai në Vërboc, lagjja Istog. Sipërfaqen e tokës pjellore të Luginës së Drenicës e mbulon sistemi i ujitjes “Ibër-Lepenc”.

5.5 Ndryshimet natyrore

Me vendosjen e paneleve diellore për prodhim të energjisë elektrike nuk do të kemi prishje të peizazhit, ky projekt do të ndikoj në zvogëlimin e CO₂ dhe i njëjti do të jetë shumë miqësor me natyrën.

Lokacioni për përmbajtje të pastra të prodhimit dhe shfrytëzim përkatës komercial, mund të zhvillohen në kuadër të vendbanimeve, vetëm nëse ato nuk shkaktojnë ndikim negativ në mjedisin që i rrethon (emisioni i gazrave, ndotja e ajrit dhe ujit, zhurma).

6. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Me investimin e pompës së derivateve (naftës, benzinë, gazit) me restaurant, market dhe autolarje paraqet një kontribut mjaft të vlefshëm për produkte që do të ofroj si dhe për mundësitë e punësimit.

Ndikimet në mjedis vinë në shprehje kur vepron faktori antropogjen në mjedis, vetëm se në shkallë të caktuara duke filluar nga minimumi real i këtij ndikimi. Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqesim në këtë rast një analizë më të hollësishme të ndikimeve të mundshme në mjedis duke specifikuar edhe masat zbutëse që do të përdoren për të eliminuar apo për të i minimizuar këto ndikime.

Gjatë punës kontinuele të pompës së derivateve vjen deri te rritja e emisionit të materieve ndotëse nga puna e automjeteve, avullimi i derivatit benzinë, derdhjet dhe avullimi i derivateve të lëngët, krijohet zhurmë nga motorët e automjeteve dhe funksionimi i automatëve për dhënie të derivateve. Në mënyrë indirekte mund të vjen edhe te deri te ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe sipërfaqeve të dheut afër pompës së derivateve.

Analiza e VNM-së në këtë rast realizohet duke u bazuar në projektin kryesor të përfunduar më lart në këtë raport si dhe nga gjendja reale në lokacionin respektivisht zonën ku është duke u ndërtuar pompa e derivateve (naftës, benzinës, gazit) me restaurant, market dhe autolarje nga **“Tallku” SH.P.K.** Kjo analizë kryhet me qëllim të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit duke mos i cenuar aspektet: kimike-fizike (ndikimet në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit), biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferë) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme apo të përhershme pozitive apo negative).

6.1 Ndikimet në ajër

Për periudhën e ndërtimit dhe operimit të pompës së derivateve **"ARIA PETROL 1 "**, ndikimet në ajër do të variojnë për shkak të aktiviteteve të ndryshme që do të zhvillohen. Ja si ndahen ndikimet gjatë këtyre dy fazave:

Ndikimet gjatë Ndërtimit - Aktivitetet si gërmimi, asfaltimi dhe transportimi i materialeve ndërtimore mund të krijojnë pluhur që do të përhapet në ajër. Përdorimi i mjeteve të rënda ndërtimi, si ekskavatorë, kamionë dhe makineri tjera, do të krijojë emetime të gazrave të ndotura si CO₂, NO_x dhe PM (grimca të imëta). Në këtë fazë do të ketë lëvizje të shpeshta të kamionëve që transportojnë materialet e ndërtimit, të cilët do të kontribuojnë në ndotjen e ajrit nga gazrat e automjeteve.

Ndikimet gjatë Operimit - Gjatë furnizimit dhe shpërndarjes së derivateve si benzina, nafta dhe gazi i lëngëzuar, mund të ndodhin avullime që shkaktojnë emetimin e komponimeve organike të avullueshme (VOC). Qarkullimi i vazhdueshëm i automjeteve që vizitojnë pompën (në veçanti nga transporti i derivatve dhe klientët) mund të shkaktojë emetimin e gazrave si CO₂ dhe NO_x, të cilët janë të dëmshëm për ajrin dhe mund të ndikojnë në shëndetin publik. Sistemet e ventilimit dhe ftohjes, veçanërisht ato që përdoren për trajtimin e gazrave, mund të krijojnë emetime të papërpunuara në ajër.

6.2 Ndikimet në tokë

Ndërtimi dhe operimi i pompës së derivateve “**ARIA PETROL 1**” me infrastrukturën përcjellëse në Arllat paraqet disa ndikime të rëndësishme në cilësinë dhe integritetin e tokës. Këto ndikime mund të ndahen në dy faza kryesore: faza e ndërtimit dhe faza e operimit.

Gjatë fazës së ndërtimit, aktivitetet që ndikojnë në tokë përfshijnë gërmimet, nivelimin e terrenit, ndërtimin e strukturave dhe transportin e materialeve ndërtimore. Proceset e gërmimit dhe nivelimit të terrenit mund të çojnë në zhvendosjen e shtresave natyrore të dheut, duke ndryshuar strukturën dhe përbërjen e tokës. Kompaktimi i tokës nga makineritë e rënda mund të reduktojë porozitetin e saj, duke ndikuar negativisht në infiltrimin e ujit dhe ajrimit të tokës. Aktivitetet e ndërtimit mund të rrisin rrezikun e erozionit të tokës, sidomos nëse nuk përdoren masa mbrojtëse për të stabilizuar dheun e ekspozuar. Gjatë ndërtimit, ekziston rreziku i ndotjes së tokës për shkak të derdhjeve të mundshme të derivateve, vajrave lubrifikantë të përdorura në procesin e ndërtimit. Mbetjet ndërtimore dhe mbeturinat jo të menaxhuara siç duhet mund të përkeqësojnë cilësinë e tokës dhe të krijojnë ndotje afatgjatë.

Gjatë funksionimit të pompës së derivateve, ndikimet në tokë lidhen kryesisht me derdhjet aksidentale të derivateve (naftë, benzinë, gaz) gjatë furnizimit ose transportit mund të përshkojnë nëpër shtresat e dheut dhe të ndotin burimet ujore nëntokësore. Pompa e derivateve përmban rezervuarë të nëndheshëm të derivatit, të cilët në rast të rrjedhjeve mund të shkaktojnë ndotje afatgjatë të tokës. Aktivitetet e lidhura me restorantin dhe marketin mund të çojnë në grumbullimin e mbeturinave të ngurta, të cilat nëse nuk menaxhohen siç duhet, mund të ndikojnë në tokën dhe ekosistemet përreth.

6.3 Ndikimet në ujë

Ndikimet në burimet ujore janë një aspekt i rëndësishëm i vlerësimit të ndikimit në mjedis për projekte të tilla si ndërtimi dhe operimi i pompës së derivateve “**ARIA PETROL 1**” me infrastrukturën përcjellëse.

Gjatë fazës së ndërtimit, mund të ndodhin disa ndikime të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në burimet ujore për shkak të aktiviteteve si gërmimi, niveli i ndotjes, dhe përdorimi i materialeve ndërtimore. Gjatë ndërtimit, heqja e shtresave të tokës dhe gërmimi mund të çojë në rritjen e erozionit dhe shpërndarjen e sedimentit në lumenj të afërm. Gjatë fazës së ndërtimit mund të krijohen ujëra të ndotura nga përdorimi i makinave ndërtimore, pastrimi i pajisjeve dhe ndërhyrjet në terren. Nëse këto ujëra të ndotura nuk menaxhohen siç duhet, ato mund të shkarkohen në burimet ujore të afërta, duke ndikuar në cilësinë e ujit.

Faza e operimit përfshin proceset e shpërndarjes së derivateve, ruajtjes dhe menaxhimit të derivateve dhe mund të çojë në ndikime të mëtejshme në ujë. Depozitat e magazinimit të derivateve dhe infrastruktura përkatëse paraqesin rrezik për rrjedhje, derdhje dhe ndotje të ujërave nëntokësore, duke dëmtuar potencialisht burimet lokale të ujit. Rrjedha nga zonat me derivate mund të bartë ndotës si vaji dhe yndyrat në ujërat sipërfaqësore aty pranë, duke ndikuar në ekosistemet ujore. Rrjedhjet ose derdhjet nga rezervuarët nëntokësorë mund të ndotin tokën dhe ujërat nëntokësore, duke paraqitur rreziqe për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

6.4 Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Sipas analizave të bëra deri tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mund të vjen deri te ndikimet në florë dhe faunë. Mirëpo sipas gjendjes faktike në teren respektivisht në lokacionin e caktuar nuk kemi zhdukje të vegjetacionit sepse lokacioni ku është planifikuar ndërtimi i pompës së derivateve përdoret si parking për makineritë e biznesit të kompanisë, pos nga sipërfaqet nën objekte dhe në platonë e pompës së derivateve “ARIA PETROL 1” kjo do të thotë se kemi të bëjmë me koncentrim të vogël të ndotjes. E njëjta do të vrente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet të ketë ndikime negative, se fauna edhe ma herët nuk ka ekzistuar në këtë lokacion sepse në këtë lokacion ka makineri të renda të cilat nuk e kane lejuar zhvillimin e faunës.

6.5 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Hapësira ku ka filluar ndërtimi i pompës së derivateve “ARIA PETROL 1” nuk ka ndikim negative në popullatën e zonës pasi që lokacioni ku ka filluar ndërtimi i pompës së derivateve është zonë ndërtimore sipas planit zhvillimor të komunës së Gllogocit. Distanca nga shtëpitë e banimit është 549m gjë që nuk mund të ndikoj në. Në të kundërtën, ka ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të zonës dhe ndihmon në mbështetje përmes punësimit të komunitetit lokal në këtë pompë derivatesh, njëkohësisht popullata mund të relaksohet dhe të ushqehet në restorantin e kompanisë e cila i plotëson të gjitha nevojat e qytetarëve të asaj zone.

6.6 Ndikimet nga zhurma

Në domenin e mbrojtjes së mjedisit zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin nervor, në hipertension, në koncentrim të njeriut në punë etj. Lokacioni i pompës me derivate “**ARIA PETROL 1**” me objektet përcjellëse është i ekspozuar zhurmës së krijuar nga qarkullimi i automjeteve, autocisternave dhe nga funksionimi i pompave dhe kompresorëve për zbrazen dhe shpërndarjen e derivateve dhe në mungesë të energjisë elektrike kyçja e shpeshtë e agregatit për energji elektrike. Sipas gjendjes faktike të kompleksit të pompës së derivateve në lokacionin e analizuar mund të konstatojmë se niveli zhurmës i shprehur në dB do të jetë nën vlerën e lejuar prej 60 dB.

6.7 Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Pompat e derivateve mund të paraqesin rreziqe sigurie për shkak të natyrës së ndezshme të derivateve që ato ruajnë. Masat adekuate të sigurisë dhe planet e reagimit ndaj emergjencave janë thelbësore për të zbutur këto rreziqe.

Për këtë arsye kompania ka siguruar pëlqimin nga Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave në lokacion.

6.8 Trashëgimia Kulturore

Si pas hulumtimit të materialeve përkatëse dhe nga informatat e siguruar në teren dhe Komunë, në lokacionin e ngushtë, ku është duke u ndërtuar pompa e derivateve “**ARIA PETROL 1**” në lokacionin e komunës së Glllogocit, nuk ka as zona të mbrojtura të trashëgimisë historike, kulturore apo natyrore. Zona e mbrojtur më e afërt është ajo e zonës me interes të veçantë Kleçkë dhe Divjak në distancë 1.26 km.



Figura 11. Zona e mbrojtur më e afërt është ajo e zonës me interes të veçantë Kleçkë dhe Divjak në distancë 1.26 km

7. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS

Ndërtimi i pompës së derivateve, mund të ketë pasoja të ndryshme mjedisore, si gjatë fazës së ndërtimit ashtu edhe gjatë gjithë jetës së tij funksionale. Është e rëndësishme të theksohet se ndikimi specifik mund të ndryshojë në varësi të faktorëve të tillë si vendndodhja, dizajni dhe pajtueshmëria rregullatore. Këtu janë disa pasoja të mundshme:

Çrregullimi i tokës: Gjatë ndërtimit, mund të ketë shqetësime të konsiderueshme të tokës, duke përfshirë gjurmimin, klasifikimin dhe heqjen e bimësisë. Kjo mund të çojë në erozionin e tokës, ndërprerjen e habitatit dhe ndryshimin e modeleve natyrore të kullimit.

Ndotja e ujit: Aktivitetet e ndërtimit mund të sjellin ndotës në trupat ujorë të afërt përmes rrjedhjeve. Ndotës të tillë si sedimentet, kimikatet e ndërtimit dhe nafta mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e ujit dhe ekosistemet ujore.

Cilësia e ajrit: Aktivitetet e ndërtimit dhe trafiku pasues i automjeteve në pompën e derivateve mund të kontribuojnë në ndotjen e ajrit. Emetimet nga pajisjet e ndërtimit dhe automjetet, si dhe avujt nga operacionet e furnizimit me derivate, mund të çlirojnë ndotës si grimcat, oksidet e azotit dhe komponimet organike të paqëndrueshme.

Zhurma: Operacionet e pompës së derivateve mund të gjenerojnë zhurmë gjatë fazës së ndërtimit ndërsa gjatë fazës së operimit ndikim më të madh ka nga rruga që gjendet afër pompës.

Ndotja e ujërave nëntokësore: Rezervuarët dhe tubacionet nëntokësore të depozitimit të derivatit paraqesin rrezik për rrjedhje ose derdhje, duke çuar në ndotjen e ujërave nëntokësore. Benzina dhe produktet e tjera të naftës përmbajnë substanca të dëmshme që mund të qëndrojnë në mjedis dhe të ndikojnë në furnizimin me ujë të pijshëm.

Bllokimi i trafikut dhe ndikimi në infrastrukturë: Rritja e trafikut rreth pompës së derivateve mund të kontribuojë në mbipopullim dhe të stresojë infrastrukturën lokale. Kjo mund të çojë në ndërtim dhe mirëmbajtje shtesë të rrugëve, duke ndikuar më tej në mjedisin përreth.

Pajtueshmëria rregullatore: Mosrespektimi i rregulloreve mjedisore mund të çojë në pasoja ligjore, gjoba dhe kërkesë për masa korrigjuese. Zbutja e këtyre pasojave mjedisore shpesh përfshin zbatimin e praktikave më të mira, respektimin e rregulloreve mjedisore dhe miratimin e teknologjive dhe praktikave që minimizojnë ndikimin e ndërtimit dhe funksionimit të pompave të derivatit në ekosistemin përreth.

8. PERSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE

Metodat për vlerësimin e pasojave mjedisore janë të rëndësishme për menaxhimin dhe minimizimin e ndikimeve negative që mund të kenë projektet dhe aktivitetet në mjedis. Për të siguruar që një sistem menaxhimi mjedisor të jetë efektiv dhe të përmbushë standardet, përdoren disa metoda të caktuara që ndihmojnë në vlerësimin dhe monitorimin e ndikimeve. Ja disa nga këto metoda të përdorura për vlerësimin e pasojave mjedisore:

➤ Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore (VNM)

Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore është një metodë që shqyrton ndikimet e mundshme të një projekti në mjedis para se të fillojë ai. Ky proces përfshin:

- **Studimi dhe Analiza:** Identifikimi i ndikimeve potenciale dhe vlerësimi i efekteve të mundshme mbi ajrin, tokën, ujin, florën dhe faunën.
- **Raportimi:** Krijimi i një raporti të detajuar që përmbledh gjetjet dhe rekomandimet për masat e zbutjes.
- **Konsultimi:** Angazhimi i palëve të interesuara dhe publikimit të raportit për të marrë feedback dhe për të siguruar transparencë.

➤ Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit (SMM)

Një Sistem i Menaxhimit të Mjedisit është një metodë sistematike për të menaxhuar dhe kontrolluar ndikimet mjedisore të një organizate. Ky sistem përfshin:

- **Planifikimi:** Identifikimi i ndikimeve dhe krijimi i planeve për të përmbushur kërkesat mjedisore.
- **Implementimi:** Zbatimi i politikave dhe procedurave për të menaxhuar ndikimet mjedisore.
- **Kontrolli dhe Monitorimi:** Monitorimi i performancës mjedisore dhe auditimi për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe rregulloret.
- **Përmirësimi:** Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave për të përmirësuar performancën mjedisore.

➤ Analiza e Ciklit të Jetës (ACJ)

Analiza e Ciklit të Jetës shqyrton ndikimet mjedisore të një produkti gjatë të gjithë ciklit të tij, nga ekstraktimi i lëndëve të para deri në përdorim dhe asgjësim. Ky proces përfshin:

- **Hulumtimi i Ndikimeve:** Vlerësimi i ndikimeve gjatë fazave të ndryshme të ciklit të jetës së produktit.
- **Krahasimi:** Krahasimi i ndikimeve të ndryshme për të identifikuar mundësitë për përmirësim.

- **Raportimi:** Krijimi i një raporti që tregon ndikimet dhe rekomandimet për përmirësim.

➤ Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore (SNASh)

Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore shqyrton ndikimet e një projekti jo vetëm në mjedis, por edhe në shëndetin e njeriut. Ky studim përfshin:

- **Analiza e Rrezikut për Shëndetin:** Vlerësimi i rreziqeve të mundshme për shëndetin nga ndotja dhe ekspozimi ndaj substancave të dëmshme.
- **Studimi i Efekteve në Komunitet:** Analiza e ndikimeve në cilësinë e jetesës dhe shëndetin e komunitetit përreth.

➤ Analiza e Rrezikut Ambientale

Analiza e Rrezikut Ambientale fokusohet në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që një projekt mund të sjellë për mjedisin. Ky proces përfshin:

- **Identifikimi i Rreziqeve:** Përcaktimi i mundësive dhe probabilitetit të ndodhies së incidenteve ndotëse.
- **Vlerësimi i Pasojave:** Analiza e pasojave për ambientin në rast të ndodhies së këtyre incidenteve.

9. PERSHKRIMI I MASAVE

Sipas analizës së bërë mbi ndikimin në mjedis e pompës së derivateve “**ARIA PETROL 1**” me investitor “Tallku” SH.P.K., si dhe në bazë të vlerësimit të kompleksit i cili do të punohet sipas projektit kryesor të ndërtimit dhe rekomandimeve të dhëna në këtë raport, Pompa e Derivateve në lokacionin e Arllatit, K. Gllogoc, me veprimtarinë kontinuele të sajë, nuk rrezikon mjedisin në maste të palejueshme, sepse janë realizuar shumë nga parakushtet e nevojshme për mbrojtjen adekuate të mjedisit, por megjithatë duhet të parashihet që në rast se vjen deri te ndotja duhet të ndermirren masat për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative që shpijnë deri te rrezikimi i mjedisit jetësor.

Me qëllim të zvogëlimit të mëtejshmë të ndikimeve potenciale negative në mjedis, rekomandohet ndërmarrja e masave të cilat bëjnë pjesë në domenin e menaxhimit të rrezikut në pompën derivateve në rrethanat e jashtëzakonshme dhe të rregullta

9.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për të minimizuar ndikimet negative në ajër nga ndërtimi dhe funksionimi i pompës së derivateve “**ARIA PETROL 1**” me infrastrukturë përcjellëse duhet të merren një sërë masash që synojnë zvogëlimin e emisioneve të gazrave ndotës dhe pluhurit në atmosferë, si dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit. Gjatë aktiviteteve të gërmimit, nivelimit të terrenit dhe transportit të materialeve, është e nevojshme që të mbulohen sipërfaqet që krijojnë pluhur dhe të përdoren sisteme për spërkatje me ujë për të reduktuar ndotjen e ajrit nga pluhuri. Përdorimi i mjeteve që përdorin derivate më të pastra dhe të standardizuara për të ulur emisionet e gazrave si dioksidi i azotit (NO₂), dioksidi i squfurit (SO₂), monoksidi i karbonit (CO), dhe grimcat e imëta (PM). Të ketë gjelbërim brenda hapësirës së pompës në mënyrë që cilësia e ajrit të jetë më e mirë për shkak të veturave që kalojnë gjatë rrugës në afërsi. Me qëllim të zvogëlimit të ndotjes së ajrit e cila ndodhë si produkt i aromës së keqe që lirohet nga hapësirat e kuzhinës duhet të bëhet ventilimi i hapësirave të tyre.

9.2 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë

Për të parandaluar dhe minimizuar ndikimet negative në tokë gjatë ndërtimit dhe funksionimit të pompës së derivateve “**ARIA PETROL 1**” me infrastrukturën përcjellëse, është e nevojshme të implementohen disa masa të cilat fokusohen në mbrojtjen e cilësisë dhe integritetit të tokës. Aktivitetet e gërmimit dhe nivelimit duhet të kryhen vetëm në zonat e nevojshme për ndërtimin e strukturave. Gërmimi dhe zhvendosja e tokës duhet të realizohen në mënyrë të kontrolluar për të shmangur dëmtimin e shtresave natyrore të dheut. Shtresat e

dheut që mund të përdoren për mbulesë apo për stabilizimin e zonës duhet të ruhen dhe të ribashkohen pas ndërtimit. Përdorimi i teknikave të përshtatshme për kompaktimin e tokës që minimizojnë dëmtimin e strukturës natyrore dhe ruajnë porozitetin dhe aftësinë e infiltrimit të ujit. Sigurimi i grumbullimit dhe menaxhimit të saktë të mbeturinave ndërtimore dhe mbeturinave jo të menaxhuara. Përdorimi i konteinerëve të veçantë për lloje të ndryshme mbeturinash për të parandaluar ndotjen e tokës. Inspektimi dhe mirëmbajtja e rregullt e sistemit të furnizimit dhe shpërndarjes së derivateve për të siguruar që nuk ka rrjedhje apo humbje të derivateve. Instalimi i një sistemi efikas për menaxhimin e mbeturinave të ngurta që krijohen nga aktivitetet e restorantit dhe marketit. Mbeturinat duhet të mbahen të ndara dhe të transportohen për riciklim ose shpërndarje në vendet e përshtatshme. Pas përfundimit të fazës së ndërtimit, është e rëndësishme të riparohen dhe të restaurohen zonat e prekura, duke siguruar mbjelljen e bimëve dhe ruajtjen e biodiversitetit natyror që mund të ketë pësuar dëmtime nga ndërtimi.

9.3.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë

Edhe pse pompa e derivateve “**ARIA PETROL 1**”, nuk ka ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore, e pastaj edhe të ujërave nëntokësore, por ndotja mund të ndodhë si që e kemi përshkruar kapitujt e mësipërme. Në kompleksin e pompës së derivateve duhet të funksionojë sistemi për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura nga sipërfaqet manipuluese dhe të dërgohen në separatorin e vajrave për ndarjen e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura. Separatori për vajra me kapacitet mesatare (sipas projektit), për mes mureve e bën ndarjen (seperimin) e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura dhe i deponon në pusëtën e posaçme, ku pas mbushjes së pusëtës duhet të pastrohet nga ndërmarrjet e licencuara për pastrimin e separatorve. Separatori përmbush kriteret teknike që janë të parapara me rregullore dhe normative në fuqi. Separatori do të funksionojë sipas standardeve në hapësirën. Separatori duhet të rregullohet në at mënyrë që të mundë të kontrollohet rregullisht uji i cili pastrohet dhe të merren mostrat e ujit i cili pastrohet. Ujërat e trajtuara në separator duhet të dërgohen në kanalizimin e zonës. Ujërat nga separatori nuk guxojnë të lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë derivate të naftës mbi 1 mg/l dhe materie të suspenduara mbi 30mg/l në ujë. Ujërat nga separatorët nuk guxojnë të lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë vajra dhe yndyra mbi vlerat e përcaktuara me Udhëzimin administrativ (MMPHI) Nr.02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin e ujit.




Figura 12. Grumbullimi i ujërave atmosferike dhe separatori për ndarjen e vajrave nga uji




Figura 13. Vaske septike për para trajtim

Sa i përket trajtimit të ujërave fekale në WC dhe sanitari projektuese nuk ka parapare ndonjë grope septike apo ndonjë impiant për trajtimin e këtyre ujërave, do të ishte mirë që me projekt kryesor të planifikohen një impiant për paratrajtimin e ujërave fekale dhe atyre nga autolarja para se ato të shkarkohen në rrjetin e kanalizimit të fshatit. Përveç masave të përshkruara më lartë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të mundshme të përshkruara me lartë, investitori duhet të i ndërmerret edhe këto masa:

- ✚ Për mbrojtjen e tokës nga ndikimet negative tëra hapësirat operationale në të cilat bëhet manipulimi me derivate duhet të mbulohen me beton ose asfalt.
- ✚ Furnizimi me ujë për pije si dhe për nevoja tjera sanitari është planifikuar të bëhet nga Pusi nëntokësor sepse në afërsi nuk kemi rrjet të sistemit të ujësjellësit.
- ✚ Të gjitha ujërat atmosferike dhe ujërat të përdorura nga sipërfaqet me ndikim të mundshëm duhet të grumbullohen me kolektor dhe nëpërmjet gypave të përcjellën në separator.
- ✚ Ujërat fekale nga nyjat sanitare përmes gypave duhet të dërgohen në rrjetin e kanalizimit të asaj zonës dhe mos të shkarkohen në recipient të hapur.
- ✚ Rregullisht të bëhet kontrollimi i separatorit të vajit , pas mbushjes duhet bërë pastrimin e tij, fundërrina dhe vaji duhet të deponohen në enë të posaçme dhe pastaj të dërgohen në trajtim të mëtejshëm sipas ligjit për trajtimin e materieve të rrezikshme.
- ✚ Të vendosen kontejnerët adekuat të pajisur me kapak për deponimin e mbeturinave komunale, pas mbushjes së tyre duhet të dërgohen për zbrazje në deponin regjionale.
- ✚ Të vendosen enët adekuate për deponimin e mbeturinave të lëngëta.
- ✚ Të mbjellën sipërfaqeve dhe oazave të pa betonuara me barë dhe drunjtë dekorativ me qëllim të pastrimit të ajrit nga ndotjet me gazra, dhe për çështje vizuale.

9.3 Masat për mbrojtje nga zhurma

Pompa e derivateve, gjatë ushtrimit të aktivitetit të sajë nuk shkakton zhurmë ose mund të shkaktojë një zhurmë shumë të vogël e cila është brenda kufijve të lejuar. Parcela ku është duke u ndërtuar pompa e derivateve është afër rrugës magjistrale M9, që lidh Prizrenin me Prishtinën dhe zhurma më e madhe bëhet nga lëvizja e makinerive që lëvizin, prandaj zhurma që krijohet nga pompa e derivateve “**ARIA PETROL 1**” të kompanisë “**Tallku**” SH.P.K. është thuajse me e vogël se makinat lëvizin ngadalë dhe ato si janë duke u furnizuar duhet të jenë të fikura. Megjithatë operatori duhet të marrë të gjitha masat e parapara sipas ligjit dhe akteve nën ligjore për parandalimin dhe zvogëlimin e zhurmës në kuadër të normave të lejuara, duhet të kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impiantet të cilat prodhojnë zhurmën edhe për këtë

ndikim duhet të shkurtohet në maksimum koha e mbajtjes ndezur të motorëve të mjeteve motorike, duke mirëmbajtur dhe duhet kushtuar rendësi e veçante të gjitha pajisjeve të cilat emitojnë zhurmë gjatë procesit të punës.

9.4 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Parcela në lokacionin në të cilën është duke u ndërtuar pompa e derivateve “**ARIA PETROL 1**” nga kompania “**Tallku**” SH.P.K., nuk ka ndikim negativ në peizazh, florë dhe faunë e vendbanimit në fjalë dhe regjionit në përgjithësi. Megjithatë kompania duket të bëjë mbjelljen e sipërfaqeve të pa betonuar me barë dhe drunjtë dekorativ me qëllim të pastrimit të ajrit nga ndotja me gazra dhe për çështje vizuale.

9.5 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Në afërsi të zonës së ku është duke u ndërtuar pompa e derivateve “**ARIA PETROL 1**” nga kompania “**Tallku**”SH.P.K., nuk ka ndikim negativ në popullatë pasi është largë nga vendbanimet, por ka ndikime pozitive në zhvillimin ekonomik të zonës dhe ndihmon në mbështetje përmes punësimit të komunitetit lokal në këtë pompë derivate, njëkohësisht popullata mund të relaksohet dhe të ushqehet në restorantin e kompanisë e cila i plotëson të gjitha nevojat e qytetarëve të asaj zone.

9.6 Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore

Pompat e derivateve mund të paraqesin rreziqe sigurie për shkak të natyrës së ndezshme të derivateve që ato ruajnë. Masat adekuate të sigurisë dhe planet e reagimit ndaj emergjencave janë thelbësore për të zbutur këto rreziqe.

Për këtë arsye kompania ka siguruar pëlqimin nga Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave në lokacion.

9.7 Menaxhimi i mbeturinave

Klasifikimin dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave Kompania pompa e derivateve e bënë në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligji për Mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina. Mbeturinat e ngurta komunale, grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor.

Tabela 1 Tabela e mbeturinave jo të rrezikshme sipas katalogut shtetëror të mbeturinave

Mbeturina	Emri i mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i deponimit
20 01 01	Letër dhe Karton	Jo të rrezikshme	Kontejner
20 01 39	Plastikë	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
15 01 01 20 01 08	Mbeturine e ngurtë komunale	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina

Investitori i pompës së derivateve, riparimin dhe ndërrimin e vajrave të automjeteve transportuese, autocisternave ka planifikuar ta bëjë tek autoserviset e kontraktuar andaj nuk gjeneron vajra mbeturinë.



9.8 Masat mbrojtëse në rezervar

- Rezervarët për lëndë djegëse të lëngtë (nafte dhe benzine) do të jenë të prodhuar sipas standardeve të caktuara dhe të vendosur po ashtu sipas standardeve.
- Të gjithë gypat ajruar të rezervarëve janë të vendosur në lartësi të sigurt.
- Është obligim permanent i punëtorëve që të kontrollojë sistemin e gypave me mekanizëm për mbushje dhe zbrazje të derivateve nga rezervarët.
- Është obligim që rezervarët e derivateve të kontrollohen brenda 3-5 viteve të para të punës për të përcjell dëmtimet e trashësisë së mureve nga veprimi korroziv, pas 5 viteve kontrolli duhet bërë për çdo dy vite.

9.9 Masat mbrojtëse në sistemin shpërndarës

- Është e obligim që mekanizmi i sistemit shpërndarës dhe rezervarët të pajisen me elementin detektues të derdhjes eventuale të derivateve
- Sistemi i gypave shpërndarës me automatë për derivat të lëngët (nafte dhe benzine) është i siguruar që të pengohet derdhja eventuale e derivateve
- Pompa e derivateve duhet të pajiset me sistemin sekondar për mbledhjen e derdhjeve aksidentale.
- Pompa e derivateve duhet të pajiset me sistemin për mbledhjen e avujve që lirohen nga derivatet.

9.10 Rekomandimet tjera për evitimin e rrezikut

- ✚ Të bëhet përdorim i drejt, mbikëqyrje e rregullt dhe mirë mbajtje e pajisjeve.
- ✚ Të hartohet rregullorja ku do të definoohen procedurat për rastet aksidentale, të bëhet aftësimi i të punësuarve dhe të caktohen obligimet e tyre në situata aksidentale.
- ✚ Duhet të ndërtohet sistemi i pajisjeve kundër zjarrit me anë të ujit dhe të sigurohen aparatet me mjete kimike si dhe enët me rërë.
- ✚ Në mënyrë permanentë të mirëmbahet ambienti në kompleksin e pompes së derivateve e posaçërisht nyje sanitare, platoja me rrethin dhe gjelbërimi rrethues.

9.11 Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve

Komponenti mjedisore	Potenciali për ndikim negativ	Veprimi që shkakton ndikimin	Masat që duhet të ndërmerren
Ajri	Ka potencial te vogla për ndotjen e kualiteti të ajrit.	Pluhur dhe grimca të imëta nga germimi, nivelimi dhe transporti. Emisionet e gazrave nga automjetet dhe avullimi i derivateve	Mbulimi i sipërfaqeve që krijojnë pluhur dhe përdorimi i sistemeve për spërkatje me ujë. Përdorimi i makinerive me standarde emisioni për gazrat ndotës dhe derivate më të pastra. Gjelbrimi i hapësirave për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Ventilimi i hapësirave të kuzhinës për të reduktuar aromat e këqija.
Uji dhe Toka	Në zonë nuk ka ujëra sipërfaqësore. Potencial për ndikimin ekziston te dheu dhe ujërat nëntokësore	Gërmimi dhe nivelimi mund të ndryshojnë strukturën e tokës. Rreziku i ndotjes nga derdhjet e derivateve. Erozioni dhe shpërndarja e sedimentit. Derdhjet nga depozitat e derivateve dhe rrjedhjet e mundshme.	Aktivitetet e gërmimit dhe nivelimit duhet të bëhen vetëm në zonat e nevojshme. Përdorimi i teknikave për ruajtjen e shtresave natyrore të dheut dhe kompaktimin e tokës. Menaxhimi i mbeturinave ndërtimore dhe përdorimi i

			konteinerëve të posaçëm për mbeturina. Inspektimi dhe mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me derivate për të shmangur rrjedhjet. Instalimi i një separatori për vajra për ndarjen e derivateve nga ujërat e ndotura. Ujërat e trajtuara duhet të dërgohen në kanalizimin e zonës, dhe të kontrollohet përmbajtja e vajrave dhe yndyrave. Përdorimi i një sistemi për trajtimin e ujërave fekale dhe evituar shkarkimin e tyre në natyrë .
Natyra dhe biodiversiteti (flora dhe vegjetacioni, fauna, Zonat e mbrojtura të natyrës)	Potencial minimal, nuk ka zona të rrezikuara ose në zhdukje.	Ndikime të kufizuara në florë dhe faunë për shkak të përdorimit të tokës si parking për makineri	Nuk ka ndikime negative në peizazh, florë dhe faunë, por kompania do të mbjellë sipërfaqet e pa betonuar me barë dhe drunjt dekorativ.
Zhurma	Potencial minimal	Zhurme nga qarkullimi i automjeteve nga rruga që është afër.	Mirëpo niveli i zhurmës nuk do të jetë i atillë që të ketë ndikim të madh në ambientin jashtëm.
Shëndeti i qytetareve dhe konsumatorëve	Potencial relativ	Nuk ka ndikim pasi është largë nga vendbanimet	Në rast se do të ketë ndikim do të merren të gjitha masat e nevojshme

9. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE

Sa i përket aksidenteve apo katastrofave të mëdha që lidhen me pompën e derivateve “**ARIA PETROL 1**” nga investitori “Tallku”SH.P.K. mund të paraqes rrezik për shkak të natyrës së ndezshme të derivateve mund të paraqitet rrezik po ashtu edhe nga vetëm energjia elektrike e cila mund të djeg ndonjë instalim elektrik, por edhe për këtë kompania i ka marrur të gjitha masat duke u siguruar pëlqimin nga Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave dhe duke i marrë të gjitha masat për mbrojtjen nga zjarri.

10. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi i ndikimeve mjedisore është një proces kyç për menaxhimin e aktiviteteve. Ai është i domosdoshëm për të siguruar që operacionet e pompës së derivateve nuk dëmtojnë mjedisin dhe për të përmbushur kërkesat ligjore. Aktivitetet e pompës kërkojnë një monitorim të vazhdueshëm dhe të sistematizuar të treguesve mjedisorë, përfshirë cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës. Kjo ndihmon në identifikimin e shpejtë të ndotësve dhe të ndikimeve negative që mund të ndodhin. Produktet dhe ndikimet në mjedis do të kontrollohen rregullisht për të siguruar se ato përputhen me standardet e caktuara dhe me legjislacionin përkatës. Çdo rast i ndotjes ose shkeljes së standardeve do të trajtohet me seriozitet. Nëse identifikohen ndikime negative, do të merren masat e nevojshme për të adresuar situatën, përfshirë ndalimin e aktiviteteve që shkaktojnë ndotje dhe implementimin e masave të zbutjes. Çdo rast i ndotjes që tejkalon normat e lejuara do t'i raportohet organit kompetent, në përputhje me ligjet e aplikueshme, për të siguruar transparencën dhe përgjegjshmërinë.

Raportimi është një proces i rëndësishëm që siguron informacion të detajuar mbi gjendjen e mjedisit dhe ndikimet e aktiviteteve të pompës. Raportimi do të kryhet nga një individ i autorizuar nga menaxheri i kompanisë. Ky person do të jetë përgjegjës për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, si dhe për përgatitjen e raportit. Në raport do të përfshihen të dhëna të detajuara për monitorimin e parametrave mjedisorë që kërkohen në Pëlqimin Mjedisor, i cili lëshohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPHI). Këto të dhëna mund të përfshijnë:

- Emissionet e gazrave ndotës.
- Cilësia e ujit dhe ndotësit në ujëra të mbeturinave.
- Parametrat e cilësisë së tokës.

Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e të gjitha parametrave të cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor (lejen mjedisore e cila lëshohet pasi të pajisemi me Pëlqim Mjedisor nga MMPHI).

11. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHËSHME

Bazuar në studimin e bërë për identifikimin e ndikimeve të mundshme, masave për parandalimin e ndikimeve, projektit teknik, planit të biznesit, intervistave e opinioneve, si dhe duke iu referuar dokumenteve ekzistuese mund të kolaudohet si në vijim:

- Ky projekt është në interes të gjithë pushuesve të rajonit të Gllogocit, të gjithë atyre që kalojnë në rrugën M9 dhe normal të vet investitorit për rritjen e konsumatorëve.
- Gjithashtu do të jetë dhe në interes të komunës sepse do të ketë një ndikim modest në rritjen e punësimit dhe të hyrave në komunë, dhe në interes të banorëve të tjerë lokal, sepse do të ofrohen mundësi punësimi.
- Ky projekt nuk do të ndikoj negativisht në rajonin për rreth tij.

Duke e pasur parasysh, natyrën e projektit, vendndodhjen e projektit, kapacitetin dhe intensitetin e veprimeve, mund të konstatohet se ndikimet e këtij projekti në mjedisin janë minimale, të riparueshme dhe krejtësisht të kontrollueshme.

Me kryerjen profesionale të punimeve, me respektimin e plotë të projektit teknik, me respektimin e plotë të masave të dhëna në këtë raport mundë të përfundojmë se ky projekt i Pompës së Derivateve **“ARIA PETROL 1”** me investitor **“Tallku” Sh.p.k.** konsiderohet krejtësisht i bazuar në **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis** dhe është i pranueshëm si në aspektin mjedisor, po ashtu edhe në atë social dhe ekonomik.

Funksionimi kontinual i Pompës së Derivateve **“ARIA PETROL 1”** me investitor **“Tallku” Sh.p.k.**, është analizuar dhe përshkruar mjaftueshëm lidhur me ndikimet në mjedis dhe rrezikun eventual që paraqet për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe në pikëpamje të mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme për raport të VNM-së dhe i propozojmë institucionit kompetent përkatësisht Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturë (MMPHI), për dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës së investitorit - aplikuesit **“Tallku” SH.P.K.**

12. ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT:

Duke u bazuar ne te dhënat e projektit ideor vlera investive fillestare e këtij projekti kap shumen prej **1.0 milion euro (€)**.

“Tallku” SH.P.K.

13. LITERATURA E PERDORUR

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- Te dhënat nga Investitori,
- Projekti Konceptual,
- [Pzhk_Gllogoc-2020-2028_Final_min-size.pdf](#)
- [Harta zonale Gllogoc](#)
- [Kërko dhe paraqit - KGP](#)
- [Drenas to 42.5580683, 20.8231772 - Google Maps](#)
- [LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS \(rks-gov.net\)](#)